



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 13

24 Mars – 30 Mars 2025

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 Njesi Vendore te Kujdesit Shendetesor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas cdo NJVKSH

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 36	97%
		Kavajë	9 / 10	90%
	Durrës	Durrës	18 / 20	90%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	11 / 13	85%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	8 / 11	73%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	20 / 20	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	6 / 6	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	13 / 19	68%
		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	10 / 11	91%
	Kukës	Kukës	13 / 14	93%

		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	11 / 11	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	6 / 8	75%
VLORE	Vlorë	Vlorë	20 / 20	100%
		Sarandë	9 / 9	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	9 / 9	100%
	Gjirokastrë	Gjirokastrë	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	413 / 432	96%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 13

	JAVA 13
Diarre pa gjak	1217
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. te sipërme	7886
Inf. Resp. te poshtëme	3414
Rash me temperaturë	35
Verdheza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 jave)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut tek neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	413
% e Njësive Raportuese	96% (413/432)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë:

Fier – 11 raste

Kurbin – 2 raste


Pogradec – 2 rast

Tiranë – 14 raste


Vlorë – 3 rast

Tropoje – 3 rast

Grafiku 1. Prirja në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet ulje në javën 13 krahasuar me javën paraardhëse, java 12.

Grafiku 3. Prirja në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarre pa gjak” paraqet rritje në javën 13 krahasuar me javën paraardhëse, java 12.

Grafiku 5. Krahasoni i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 - 13 të sezonit 2023-2024 dhe sezonit 2024-2025. Numri i rasteve.




Në javën 13 të vitit 2025 vërehet një ulje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 12 dhe 13/ 2025. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 01 - 13 të sezonit 2023-2024 dhe sezonit 2024-2025. Numri i rasteve



Në javën 12 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak” por kjo rritje është pak a shumë e ngjashme me atë dy javë më parë por me e ulët se ajo e viteve të fillimit të këtij viti. Gjithsesi këtë vit vërehet një numër më i lartë i këtyre infeksioneve krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 12 dhe 13/ 2025. Incidenca (raste/10.000)



Verehet nje rritje e larte ne Bulqize, Kolonje dhe Skrapar si dhe ne Gjirokaster.

Ngjarje kombëtare

Vatër Brucelozë në gjedhë në fshatin Lohe e Sipërme, Malësi e Madhe

Në datë 28.03.2025 sektori i veterinarisë së Qarkut Shkodër njofton për raste me Brucelozë në gjedhë me 4 (lopë) në fshatin Lohe e Sipërme, Bashkia Malësi e Madhe. Shërbimi i Epidemiologjisë kreu hetimin në vatër, dhe pas komunikimit me pronaren e fermës rezulton se ferma përbëhet nga 5 krerë, qumështi dhe mishi këtyre lopeve nuk tregtohet në asnjë subjekt për konsum publik.

Gjatë hetimit në vatër nuk u konstatuan shenja të brucelozës tek familjaret apo personave të tjerë që kanë patur kontakt me kafshët e sëmura. Situata do të jetë në monitorim të vazhdueshëm në bashkëpunim me mjekun e familjes për gjendjen shëndetësore të personave të kontaktit në këtë fermë.

Gripi i shpendëve -përditësim i situatës në vendin tonë, mbështetur ne te dhenat e institucioneve pergjegjese.

Nga data 30.10.2024 -27.03.2025 numri vatrave të gripit të shpendëve në shpendë të raportuara në njoftimin e menjërshtë nga MBZHR rezulton në 11 vatra nga te cilat 2 jane ende aktive .

Nga përditësimi i fundit datë 26-27.03.2025 ka vazhduar shpërthimi në 2 kapanone të stabilimenteve REAS dhe AIBA në pula për vezë dhe zogj.

Nga monitorimi i kryer në këto stabilimente nga grupet e punës në terren janë marrë 25 kampione material patologjik për ekzaminim tampon nga kloaka dhe trakeja, të cilët kanë rezultuar Pozitiv për A(H5N1) me metodën molekulare Molekulare RT-PCR

Tabela 3. Numri i vatrave të raportuara në shpendë për periudhën 30.10.2024 - 27.03.2025

Njvqsh	Nr.vatrave total	Vendndodhja	Lloji i shpendëve të prekur
Tiranë	4	Kodër -Mëzez /zalt	Pulë fushe
		Zall-Herr	Pulë deti
		Babrru qendër	Pulë fushe
		Pakuqan	Pulë fushe
Vlorë	2	Plazhi vjetër	Shpend i egër /pulëbardhë
		Laguna Nartë	Shpend i egër Pelikan/patë e egër

Lushnjë	1	Laguna Karavasta	Pulëbardhë kembë verdhë
Gjirokastrë	1	Lunxhëri/Valare	Pulë fushe
Durrës	3	Rrashbull/Reas	Pula/prodhimi /veze
		Kulle/Sukth	Pulë fushe
		Rrashbull /Aiba	Pula prodhimi/zogj
Total	11		

Testimi dhe Diagnostikimi ne shpende

Nga ISUV jane analizuar **(25 Mostra)** ne shpende, te cilat kane rezultuar Pozitiv per Influenca Aviare A(H5N1).

Testimi dhe Diagnostikimi ne njerez

Nga NJVKSH Durrës qe nga fillimi i shperthimeve jane marre per depistim te punonjesve te pularive Aiba dhe Reas ne total 70 mostra te cilat kane rezultuar negative per gripin e shpendeve.

Situata e ngjarjes se Salmonelozes ne mishin e pules, sipas autoritetit te AKU

Sasia e mishit të kontaminuar me salmonelë ka ardhur nga importi, nga Brazili, dhe autoriteti kombëtar i ushqimit në bazë të planeve të monitorimit dhe marrjes së mostrave në pikat e inspektimit kufitar, ka kryer procedurë të tillë dhe rezultoi se produkti ishte kontaminuar me salmonelë. Sasia për të cilën bëhet fjalë është 7.9 ton.

Në datë 21 mars 2025 AKU mori informacion për raport analizën nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, dhe u hodh menjëherë në veprim për bllokimin e sasisë në magazine. AKU mori masa menjehere për identifikimin e operatorit të biznesit që kishte kryer këtë import dhe brenda ditës shkoi pranë ambienteve të tij dhe kreu kontrollet për gjetjen e produktit. Ne vazhdimësi të kontrollit është kryer gjurmueshmëria që është një process shumë i rëndësishëm, sepse nëpërmjet gjurmueshmërisë së operatorit gjenden lista, formularë ligjorë që e ka detyrim ti mbaj, pikat ku e ka tregtuar për të bërë të mundur tërheqjen mbrapsht të produktit.

Tuberkulozi

Takim online me epidemiologët, pneumologët dhe specialistët e sëmundjeve infektive në kuader të Dites Botërore të Tuberkulozit 2025. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues pneumologët në rrethet,

epidemiologët e NJVKSH, Spitali Rajonal Shefqet Ndroqi , Departamenti i semundjeve Infektive , sektori epidemiologjik ne Insitutit e Shendetit Publik si dhe perfaqesues nga zyra rajonale e OBSH ne Tirane . Te gjithë pjesemarrësit kane kontribuar me punen e tyre ne kontrollin dhe menaxhimin e Tuberkulozit ne vend. Gjithashty u theksua rendesia qe ka bashkepunimi nderinstitucional ne luften kunder Tuberkulozit , rolin qe ka secili per te bere me te mirene ne uljen e numrit te rasteve me TB ,ku Shqiperia karakterizohet nga nje indence e ulet e TB.

Pavareshtit numrit te ulet te rasteve me TB vemendja ndaj TB duhet te jete shume e lart ne kontrollin dhe menaxhimin e tij .

U paraqiti situaten e TB ne Bote ,Europe dhe ne Shqiperi duke u mbështetur ne raportin Global te Tiuberkulozit ,ku dhe vendi yne raporton cdo vit te dhenat e TB , U theksua dhe mbështetja e Insitutit te Shendetit Publik ne luften kunder TB dhe forcimin e Porgramit Kombetar teTB.

Nje pike tjeter e rendesishme e diskutimit ishte rendesia e hospitalizimit te pacienteve me TB dhe perdorimi i IGRA ne depistimin e personave te kontaktit kryesisht ne grupet me rrisht te larte. U theksua mbështetja nga ana e Insitutit te Shendetit Publik per kontrollin e cilesise se testimit te TB ne rang ndekombetar Survejanca e TB dhe situata epidemiologjike , koha e raportimit, dhe koha e diagnozes u referuan per pjeeemarrësit U theksua me shume vonesa e pacienteve me TB per diagnostikim e cila varet nga shume faktore dhe kjo kerkon nje vemendje te madhe nga mjeket e famijes dhe pneumoleget pasi gjate pandemise dhe mbrapa e kane neglizhaur pak semundjen e TB .

Kontrolli ne vater nuk eshte ne nivelin e duhur per shkak te probleme te infrastukltures ne rrethe por dhe te levizjes se vazhdueshme te personeli infemioror te dispanseirve te cilet duhet te punojne ngushte me epidemiologët e rretheve .

Nje arritje e madhe gjate vitit 2024 kemi per rritjen e numrit te mostrave te TB per testim prane Laboratorit te Referneces s eTB por dhe te permiresimit te hedhejs e te dhenave ne sistemin SISI. .Ky sistem na ka ndihmuar mjaft ne analizen e situates se Tb ne kohe si dhe per kontrollin sa me heret te perosaneve te ngushta te kontaktit te pacienteve me TB

Nje tjeret pike diskutimi ishte ne lidhje me hospitalizimi dhe trajtmti i pacienteve me TB, ku pavaresisht spitalet rajonale duhet te shtrojne paciente ne spitalet e tyre per shkak se dhe mjeket i

kane dhe infrastrukturen nuk duhet ti dergojne ne spitlain rajonal te Tiranes, Gjthashtu u theksua se pacientet qe nuk plotesojne kriteret e shtrimit ne spital nuk kane nevojte te shtrohen pro duhet ti fillihet mjekimi ambulator nen kujdesin e stafit shendeteosr pergjate gjithë fazes se mjekimit.

Gjithashtu problem tjetër që u cilesua ishte depistimi i personave të kontaktit pasi nga të dhënat e fundit të viti 2024 rreth 35% e pacientëve rezultuan nga persona kontakti. Egzaminimi për diagnozën e TB në saj dhe të testimit me Genxpert ku tregon dhe rezultatin për rezistencë ndaj rifampicine, Stafi laboratorik është i dedikuar rreth diagnostikimit të TB në saj dhe të rritjes së kapaciteteve në saj të mbështetjes së projektit të fondit global këto vitet e fundit. Problemi është vetëm mirëmbajtja e aparaturave për të funksionuar në vazhdimësi dhe pa ndërprerje, Rritja e bashkëpunimit me spitallin infektiv për pacientët që kanë nevojë për testimin me IGRA dhe sfidat e saj.

Për TB dhe infeksionistët, HIV -Tb theksua rëndësia e testimit të pacientëve për HIV në mënyrë rutine jo vetëm në spitale por dhe në NJVKSH apo dhe dispensarët e rrethëve pasi stafi i tyre është trajnuar për testimin me teste të shpejta të HIV. Vitet e fundit testimi i pacientëve me TB është në shifra shumë të kënaqshme rreth 90% por ky tregues duhet të ruhet në vazhdimësi për të testuar dhe evidentuar pacientët me Tb dhe HIV . Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve do të jetë në vazhdimësi si me takime online të cilat kanë treguar gjatë pandemisë se janë produktive por dhe fizikisht për të evidentuar konkretisht problemet rreth TB si dhe gjetjet dhe zgjidhjen e tyre në të mirë të kontrollit të TB .

Fokusi do të jetë kryesisht në TB dhe grupet e riskut por jo vetëm , mbështetjen e tyre psikologjike dhe sociale. Trajnimet e ndryshme në NJVKSH si për pneumologët dhe epidemiologët dhe gjithë stabin mjekësor.

Trajnimet do të jenë në topika të ndryshme duke u bazuar dhe në rekomandimet e fundit WHO dhe të ECDC.

Ngjarje ndërkombëtare

Influenza A(H5N1) – Monitorimi i rasteve në njerëz

- Më 23 mars 2025, u raportua nga Kamboxhia një rast fatal i infektimit të njerëzve me gripin e shpendëve A(H5N1).
- Rasti ishte një fëmijë nga provinca Kratie në veri-lindje të Kamboxhias.
- Rasti kishte ekspozim ndaj shpendëve të sëmurë dhe të ngordhur të rritur në shtëpinë e familjes.
- Që nga viti 2003, Kamboxhia ka raportuar 75 raste njerëzore të infeksionit të virusit të gripit të shpendëve A(H5N1), duke përfshirë 46 vdekjet (fataliteti i rastit midis rasteve të raportuara: 61%).

Sëmundja autoktone e virusit chikungunya - Réunion dhe Mayotte, Francë, 2024-2025

- Në gusht 2024, Franca raportoi rastin e parë autokton të sëmundjes së virusit chikungunya në 10 vjet në Réunion, me fillimin e simptomave më 12 gusht.
- Që atëherë dhe deri më 16 mars 2025, janë regjistruar 13 594 raste autoktone të sëmundjes së virusit chikungunya konfirmuar në Réunion.
- Më 21 mars 2025, u raportuan dy vdekje në individë të moshuar me sëmundje shoqëruese.
- Haute Autorité de Santé (HAS) ka këshilluar vendimmarrësit publikë që të vaksinojnë grupet që janë në një nivel më të lartë të rrezikut të sëmundjeve të rënda dhe profesionistët e kontrollit të vektorëve. Agjencia rajonale e shëndetësisë po përgatitet të ofrojë akses të vaksinave për individët me prioritet që nga fillimi i prillit.
- Më 26 mars 2025, një rast autokton i sëmundjes së virusit chikungunya u raportua në Mayotte.

Sëmundja Ebola – Uganda – 2025

- Që nga përditësimi i fundit dhe deri më 27 mars, nuk është raportuar asnjë rast i ri. Të gjitha rastet janë liruar dhe nuk ka kontakte aktive nën ndjekje.
- Numërimi mbrapsht për shpalljen e shpërthimit të mbaruar filloi pas daljes nga spitali të pacientit të fundit që ishte në trajtim.
- Që nga fillimi i shpërthimit dhe deri më 27 mars, janë konfirmuar 12 raste dhe dy raste të mundshme raportuar, duke përfshirë katër vdekje (dy raste të konfirmuara dhe dy raste të mundshme). Numri i përgjithshëm i individëve që janë shëruar është 10 (83%).
- Qytetarët e BE/ZEE që punojnë në mjediset e kujdesit shëndetësor në Ugandë duhet të jenë të vetëdijshëm për shpërthimin e vazhdueshëm dhe të marrin masat e duhura mbrojtëse personale.
- Në dritën e dëshmive nga shpërthimet e mëparshme më të mëdha, importimi i sëmundjes në BE/ZEE përmes dikujt me infeksion ka shumë pak gjasa dhe, nëse kjo ndodh, gjasat për transmetim të mëtejshëm janë shumë të ulëta.

Dita Botërore e Tuberkulozit – 2025

- Të dhënat më të fundit në raportin 'Mbikëqyrja dhe Monitorimi i Tuberkulozit në Evropë 2025' tregojnë se, megjithëse Rajoni po rimëkëmbet nga ndikimi i krizës COVID-19, efektet e pandemisë vazhdojnë të ndihen në testimin, parandalimin, diagnostikimin dhe kujdesin e tuberkulozit (TB).
- Në vitin 2023, numri i personave të diagnostikuar dhe trajtuar për TB filloi të rritet sërish, pas një rënie e paprecedentë në 2020 për shkak të ndërprerjeve të lidhura me COVID-19.
- Fëmijët nën 15 vjeç përbënin 4.3% të atyre me TB të ri dhe të relapsuar në Shëndetin Botëror

Organizata (OBSh) Rajoni Evropian, që përfaqëson një rritje shqetësuese prej 10% të TB pediatrike për vitin 2023, krahasuar me vitin e kaluar. Numra të ngjashëm janë vërejtur në Bashkimin Evropian/Zonën Ekonomike Evropiane (BE/EEA).

Chikungunya dhe Dengeja –Monitorimi i shpërthimeve globale – Përditësimi mujor

- Që nga fillimi i vitit 2025 dhe që nga marsi, rreth 80 000 raste të CHIKVD dhe 46 vdekje të lidhura me CHIKVD janë raportuar në 14 vende/territore. Rastet janë raportuar në Amerikë, Afrikë dhe Azi dhe, ndërkohë që asnjë rast nuk është raportuar në kontinentin e Evropës, në Reunion (një departament jashtë shtetit të Franca dhe rajoni më i jashtëm i Bashkimit Evropian (BE)) një shpërthim i CHIKVD është në vazhdim dhe një rast gjithashtu është raportuar në Mayotte (një departament dhe rajon i jashtëm i Francës).
- Që nga fillimi i vitit 2025 dhe që nga marsi, mbi 1.4 milionë raste të dengës dhe mbi 400 vdekje të lidhura me dengën janë raportuar nga 53 vende/territore në mbarë botën. Në kontinentin e Evropës, nuk ka raste autoktone të raportuar në vitin 2025. Megjithatë, raste janë raportuar nga rajonet më të largëta të BE-së.
- Kushtet mjedisore në zonat e Bashkimit Evropian/Zonës Ekonomike Evropiane (BE/EEA) ku *Ae. albopictus* ose *Ae. Aegypti* janë vendosur aktualisht janë të pafavorshme për aktivitetin e mushkonjave dhe replikimin e virusit në mushkonjat. Prandaj, nuk ka gjasa që të ndodhë transmetimi i virusit të chikungunya-s dhe dengës së fituar në vend derisa kushtet të bëhen të favorshme në fillim të verës.